


Shkaqet e Vdekjeve

Tiranë, më 04 korrik 2017: Numri i vdekjeve në 2016 në Shqipëri është 21.388, duke rezultuar me një normë vdekshmërie prej 74,3 për 10.000 banorë. Në numrin e vdekjeve gjatë vitit 2016, femrat zënë 47,2 % dhe meshkujt 52,8 %. Krahasuar me vitin 2015 numri i vdekjeve ka rënë me 4,6 %.

Vdekjet natyrale zënë 87,4 % të totalit në vitin 2016, pasuar nga vdekjet e shkaktuara nga aksidentet me 2,1 % dhe ato nga vetëvrasjet 1,1 %.

Koeficienti i vdekshmërisë amtare në 2016 ka rënë në 3,2 për 100.000 lindje të gjalla nga 9,0 që ishte në 2015.

Fig. 1 Vdekjet sipas shkaqeve kryesore, 2016



Në vitin 2016, rreth 52,0 % e vdekjeve janë shkaktuar nga “sëmundjet e aparatit të qarkullimit të gjakut”, të cilat për këtë periudhë janë ulur me 4,2 %, në krahasim me 2015. Ndër shkaqet e tjera që zënë peshë të rëndësishme në numrin e vdekjeve janë “tumoret” me 15,8 % të totalit. Në vitin 2016, vdekjet e shkaktuara nga tumoret janë rritur me 2,1 %, krahasuar me një vit më parë, ku nëngrupi i sëmundjeve ‘tumor në mushkëri’ përbën 20,4 %.

Tab. 1 Përqindja e vdekjeve sipas grupsëmundjeve


Kodi ICD-9	Shkaqet sipas grupsëmundjeve të vdekjeve	2015	2016
001-139	Sëmundje infektive e parazitare	0,5	0,5
140-239	Tumore	14,8	15,8
240-279	Sëmundje endokrine të të ushqyerit	0,6	1,4
280-289	Sëmundje të gjakut dhe të organeve formuese të gjakut	0,3	0,3
290-319	Sëmundje mendore	0,7	0,5
320-389	Sëmundje të sistemit nervor qendror dhe të organeve të shqisave	2,4	2,0
390-459	Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut	51,5	51,7
460-519	Sëmundje të aparatit të frymëmarrjes	3,3	2,8
520-579	Sëmundje të aparatit të tretjes	1,4	1,4
580-629	Sëmundje të organeve urogenitale	1,4	1,2
630-639	Ndërlikime të barrës, të lindjes dhe të periudhës së paslindjes	0,1	0,3
680-709	Sëmundje të lëkurës dhe të indit qelizor në lëkurë	0,2	0,2
710-739	Sëmundje të sistemit të kockave dhe të kyçeve	0,1	0,1
740-759	Anomali të bashkëlindura	0,1	0,2
760-779	Sëmundje që shfaqen në periudhën reth lindjes	0,3	0,4
780-799	Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë	14,0	15,3
800-999	Dëmtime traumatike dhe helmime	3,8	3,9
	Të panjohura*	4,4	1,9
	Gjithsej	100,0	100,0

* Kategoria 'Të panjohura' nënkupton numrin e vdekjeve për të cilat informacioni i shkakut sipas grupsëmundjeve, ku është regjistruar vdekja, mungon.

Vdekjet sipas grupmoshave

Në vitin 2016, grupmosha 50 vjeç e lart zë 92,5 % të vdekjeve dhe grupmosha 85 vjeç e lart zë 25 %. Numrin më të lartë të vdekjeve në grupmoshën 85 vjeç e lart e zënë femrat me 63,8 %. Në vitin 2016, janë regjistruar 277 vdekje nën 1 vjeç, që përbëjnë 1,3 %, të totalit. Krahasuar me 2015, numri i vdekjeve të fëmijëve nën 1 vjeç është rritur me 18,9 %. Në 2016, për grupmoshën 70-74 vjeç ka rënie të numrit të vdekjeve me 15,7 %, krahasuar me 2015.


Fig. 2 Numri i vdekjeve sipas gjinisë dhe grupmoshave 50 vjeç e lart



Vdekshmëria sipas qarqeve

Duke analizuar vdekshmërinë sipas qarqeve, norma më e lartë regjistrohet në Gjirokastrër me rreth 121 vdekje për 10.000 banorë. Nga ana tjetër vlera më e ulët regjistrohet në qarkun e Tiranës me rreth 60 vdekje për 10.000 banorë.

Fig. 3 Vdekshmëria sipas qarqeve



Metodologjia

Shkaku i vdekjes është sëmundja ose simptoma që ka shkaktuar ose kontribuar në vdekje, si dhe rrethanat e aksidentit që kanë shkaktuar këto trauma (Përshkruhet në certifikatën e vdekjes). Burimi i të dhënave është Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Klasifikimi Ndërkombëtar "ICD-9" është klasifikimi ndërkombëtar i shkaqeve të vdekjes, që bën grupimin në mënyrë të koduar të 17 grupeve kryesore të sëmundjesh. Ky kodim bëhet nga mjeku dhe përbën burimin më të plotë zyrtar statistikor të sëmundjeve që janë shkak i vdekjes.

Sëmundshmëria është frekuenca e sëmundjeve në një popullsi.

Ajo matet me: Prevalencën që është numri i të gjitha rasteve të sëmundjeve në një popullsi, në një moment të dhënë (frekuenca e çastit), ose gjatë një periudhe të dhënë, pa dallim nëse sëmundja është në fillim ose jo dhe pa dallim ndërmjet rasteve të reja apo të vjetra.

Vdekja nënkupton zhdukjen e qëndrueshme të të gjitha shenjave të jetës në një moment të çfarëdoshëm pas një lindjeje të gjallë (ndërprerjen e funksioneve jetësore pa mundësi reanimimi). Ky përkufizim nuk përmban vdekjen fetale.

Vdekshmëria shpreh vdekjet si një komponent i ndryshimit të popullsisë, e cila i ndodh çdo pjestari të popullsisë.

Vdekja Amtare është vdekja e një gruaje që ndodh gjatë periudhës së shtatëzarisë ose brënda 42 ditëve mbas përfundimit të saj, cilado të jetë zgjatja ose lokalizimi, nga një shkak çfarëdo i përcaktuar ose i rënduar nga barra ose nga ndihma e dhënë për barrën por jo aksidentale ose e papritur. Burimi i të dhënave është Instituti i Shëndetit Publik.